



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME



Drejtoria për Shërbime Publike
Uprava za Javne Službe / Directorate for Public Services

Data/Datum/Date:	20.09.2022
Nr./Br./No.	08/11
Për/Za/To:	Sekretaria e Kuvendit Komunal në Shtime
Përmes/Preko/Through:	Drejtëpërdrejtë
Nga/Od/From:	Drejtor për Shërbime Publike: Bardhyl Rushiti
Lënda/Predmet/Subject:	Informata për menaxhimin e mbeturinave dhe përgatitja dimërore

Të nderuar

Drejtoria e Shërbimeve Publike ju njofton se gjatë vitit 2022, kompania KRM "Pastërtia" ka pasur vështirësi të vazhdueshme për grumbullimin e mbeturinave dhe largimin e tyre për shkak të mungesës së mekanizmit të vjetruar dhe mungesës së makinerive adekuate që i plotësojnë kushtet për punë me theks të veçantë në kohën e verës kur kemi pasur fluksin më të madh të mërgimtarëve, ku sasia e mbeturinave ka qenë më e madhe. Gjatë këtij viti, fatmirësisht kemi qenë përfitues të tre kamionëve për grumbullimin e mbeturinave në territorin e komunës së Shtimes. Dy prej të cilëve janë përfituar nga Qeveria Japoneze dhe një nga GIZ-i gjerman.

Në bashkëpunim me kompaninë e kemi bërë ndryshimin e orarit për grumbullimin e mbeturinave në qytetin e Shtimes.

Gjatë vitit 2021-2022 (Mars 2021 – Mars 2022) janë identifikuar 23 deponi ilegale në komunën e Shtimes. Për arsye të mungesës së buxhetit, nuk ka qenë e mundur eliminimi i deponive ilegale, por që shpresojmë se do të gjejmë zgjidhje në të ardhmen. Sfidë në vetë sa i përket menaxhimit të mbeturinave, mbetet caktimi i një lokacioni për grumbullimin e mbeturinave inerte.

Ndërsa, sa i përket informatës për sezonin dimëror, ju informoj se kemi gjetur një kontratë kornizë e cila është aktive edhe këtë vit me kompaninë N.T.P. "Ardhmëria", për

Mirëmbajtjen e rrugëve lokale gjatë sezonës dimërore, e lidhur me datë: 01.11.2018 me nr. prot: 03/1/74

Drejtoria për Shërbime Publike është e gatshme për çdo lloj intervenimi gjatë sezonit dimëror për pastrimin e borës dhe akullit në të gjitha rrugët lokale në komunën e Shtimes, si dhe hedhja e kripës në rrugët e asfaltuara.

Njëkohësisht, në kontratë parashihet edhe pastrimi i borës nga trotuarët, pastrimi i borës nga parqet dhe varrezat dhe pastrimi i shkallëve nga bora dhe akulli.